



Fletë teknike: FE 50 Largo

27.04.10.
T 005-01a

Knauf Fließestrich FE 50 *Largo*

Shtresë e varfër vetëniveluese, për përpunim me makineri

Përshkrimi i materialit

Knauf FE 50 Largo është një llaç i thatë, i parapërgatitur për shtresë të varfër, vetëniveluese, me bazë sulfat kalciumi, i cili përzihet me ujë të pastër. Ai përbëhet nga anhidriti, gips special, element rrjedhës dhe material shtesë (0-4 mm), si anhidrit natyror kokrrizor ose rërë kuarci.

Klasifikimi i cilësisë sipas DIN EN 13813:

CA-C25-F5

Paketimi

Thesi 40 kg
Paleta 1200 kg

Nr.materialit 00005182

Fushat e përdorimit

Knauf Fließestrich FE 50 është një shtresë e varfër vetëniveluese për vila, blloqe vilash, ndërtime banimi dhe zyra shumëkatëshe, si:

- Shtresë e varfër notuese, trashësi ≥ 35 mm
- Shtresë e varfër mbi një shtresë ndarëse trashësi ≥ 35 mm mbi tubat e ngrohjes;
- Shtresë e varfër mbi një shtresë ndarëse trashësi ≥ 30 mm
- Shtresë e varfër e lidhur, trashësi ≥ 25 mm

Zbatimi

Për 40 kg material të thatë (1 thes) nevojiten rreth 5.5 – 6.0 litër ujë të pastër.

Knauf Fließestrich FE 50 Largo përzihet me ujë të pastër me pompë përzierëse (p.sh Ferro 100, PFT G4/G5 ose të tjera) dhe hidhet me pompë mbi sipërfaqen e parapërgatitur. Masa e rrjedhshme e këshillueshme 38-43 cm përcaktohet me cilindër testi për konsistencë 1,3 l mbi një sipërfaqe të sheshtë jo thithëse. Gjatë derdhjes nuk lejohet të ndahet uji nga llaçi!

Të dhënat teknike

Densiteti

i thatë rreth 2,0 - 2,1 kg/l
i lagët rreth 2,2 - 2,3 kg/l

Masa vëllimore

e materialit të thatë 1,6 kg/l

Frytshmëria nga 100 kg

Llaç i thatë rreth 53 l

Koha e përpunimit

rreth 60 minuta

Harxhimi i materialit

çdo 1 cm shtresë rreth 19 kg/m²

Fortësia në shtypje

i thatë > 25 N/mm²

Fortësia në përkulje

i thatë > 5 N/mm²

Bymimi i lirë

gjatë lidhjes rreth 0,1 mm/m

Transmetimi i nxehtësisë $\lambda_z = 1,4 - 1,6$ W/(m·K)

Koeficienti i bymimit nga nxehtësia

rreth 0,016 mm/(m·K)

Reaksioni i llaçit

alkalin

Moduli i elasticitetit

rreth 17.000 N/mm²

Klasa e materialit A1

jo i djegshëm

I shkëlqshëm

pas rreth 24 orësh

I ngarkueshëm

pas rreth 3 ditësh

Magazinimi i materialit

deri në 6 muaj

Fugat e lëvizjes

Knauf Fließestrich FE 50 Largo përforcon me një volum stabil shtresën e dyshemesë. Fugat e lëvizjes janë të domosdoshme vetëm kur aplikohen ngrohje nga dyshemeja. Fugat e objektit duhet të ndërtohen në të njëjtin vend në gjerësi të plotë sipas projektit.

Fugat e punës mundet të ndërtohen sipas ecurisë së punës, rendimentit të makinerisë dhe madhësisë së objektit.

Fugat e lëvizjes tek dyshemetë me ngrohje

Në varësi të madhësisë së sipërfaqes dhe formës së projektit mund të jetë i nevojshëm ndërtimi i fugave. Janë të nevojshme fugat në dyer (gjerësia e derës), në sipërfaqe me gjatësi anësore mbi 10 m, në kapërcimet dhe bashkimet e sipërfaqeve.